

Filloi sot - Kampi Ditor për Fëmijë të moshës 5 - 13 vjeç



Me Bekimin e Mitropolitit tonë të dashur Hirësisë së Tij – Imzot IGNATIT dhe nën kujdesin e veçantë të At Anastasit – Priftit të Kishës sonë si edhe nën drejtimin e mësueseve të katekizmit znj. Elena (Rovena) Bardho dhe znj. Valbona Kashari – u zhvillua sot Dita e Parë e Kampit Ditor me pjesëmarrjen e fëmijëve të moshave të ndryshme të Kolonjës.

Pas mësimit të parë me temë: “Pagëzimi – mundësi për ne, për në Parajsën Qiellore” që u bë nga znj.Valbona Kashari – fëmijët mësuan të bënin figura me anë të letrave me ngjyra, duke i prerë e duke i ngjyrosur ato.

Më pas, fëmijët u kënaqën, duke luajtur me lojëra të ndryshme në ambjentet jashtë

Kishës dhe tek fusha e saj.

Herë pas here fëmijët, sa herë që lodheshin kur luanin, uleshin dhe merrnin qerasje të ndryshme, të cilat ishin blerë enkas për ata.

Geplaatst door [Zyra e Katekizmit "Mitropolia Berat"](#) op [Maandag 2 september 2019](#)

[Zyra e Katekizmit "Mitropolia Berat"/facebook](#)